



Prishtinë: 12.02.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1230_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e ZRRE-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2018_12_19**.

në seancën e mbajtur më datë 12.02.2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit E. F. K. G. nga Komuna e Ferizajt, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është parashtruar ankesa nga konsumatori E. F. K. G. (parashtruesi i ankesës B. M.) me shifër DFE – 9021379 me të cilën është kundërshtuar përgjigja e lëshuar nga KESCO, lidhur me kontestimin e faturës për periudhën dhjetor 2016, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr.40239775..

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 01.01.2017 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2016 në vlerë financiare **5,705.55€**.

Provë: Fatura nr.12160DFE-9021379 e datës 01.01.2017

Me datë 10.01.2017 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që t'i bëhet ri shqyrtimi i faturës për periudhën dhjetor 2016 me njehsorin elektrik nr.40239775 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë.

Provë: Ankesa e konsumatorit e datës 10.01.2017

Me datë 22.02.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe të dhënave elektronike/softuerike nga njehsori elektrik.

Provë: Përgjigja e KESCO e datës 22.02.2017

Me datë 13.03.2017 konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO, si dhe ka kërkuar t'i bëhet ri shqyrtimi i faturës për periudhën dhjetor 2016 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë të njehsorin elektrik nr.40239775.

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE-së me datë 13.03.2017



Bordi i ZRRE pas analizave të të gjitha dëshmimeve të paraqitura nga konsumatori dhe KESCO/KEDS, ka vërejtur se:

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 01.01.2017 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2016 në vlerë financiare **5,705.55€**. Me datë 10.01.2017 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që ti behet ri shqyrtimi i faturës për periudhën dhjetor 2016 me njehsorin elektrik nr. 40239775 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë

Provë: Fatura nr.12160DFE-9021379 e datës 01.01.2017 dhe ankesa e konsumatorit në KESCO e datës 10.01.2017

Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Krahasimi i shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e më hershme dhe të më vonshme me njehsorin elektrik nr.40239775 vërteton se konsumatori ka luhatje në shpenzimin e energjisë në periudha të caktuara. Sipas rrjedhës se energjisë elektrike shpenzimi i konsumatorit për periudhat e më hershme të njëjta me njehsorin elektrik nr.40239775 janë: periudha 12/2015 është 1,300 kWh, periudha 12/2014 është 1,421 kWh, kurse për periudhat e më vonshme periudhën 12/2017 është 3,209 kWh si dhe periudhën 12/2018 është 4,722 kWh. Bazuar në argumentet e paraqitura vërtetohet se konsumatori nga periudha 2016 e tutje ka rritje graduale të shpenzimeve të energjisë elektrike.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike

Bordi i ZRRE ka analizuar listat e leximit për periudhën 09/2016 deri më 02/2017 dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë lexime të rregullta mujore. Sipas listave të leximit konstatohet se shpenzimet mujore janë: periudha 09/2016 është TL=7739.94 kWh dhe TU=3873.56 kWh, periudha 10/2016 është TL=7975.89 kWh dhe TU=4036.03 kWh, periudha 11/2016 është TL=8217.37 kWh dhe TU=4206.11 kWh, periudha 12/2016 është TL=8664.08 kWh dhe TU=4462.46 kWh, periudha 01/2017 është TL=8722.46 kWh dhe TU=4492.34 kWh si dhe periudha 02/2017 TL=8947.63 kWh dhe TU=4622.42 kWh. Bazuar në analizën e listave të leximit nuk vërehet se lexuesi i KEDS-it në çfarëdo periudhe ka konstatuar se nuk ka qasje në leximin e shpenzimeve mujore.

Provë: Listat e leximit periudha 09/2016 deri më 02/2017

Bordi i ZRRE bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listave të leximit konstaton se Departamenti i faturimit në KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.”*

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: **E. F. K. G (parashtruesi i ankesës B. M.)**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së